

REPUBLICA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHK.PARË JUR.PERGJ VLORË  
NR.RREGJ.THEM.418  
DATA E RREGJISTRIMIT 01.06.2023

NR.418 VENDIMI  
DATA 13.06.2023

## V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
VLORË E PËRBËRË NGA:  
HERILA ÇELA – GJYQTARE

Asistuar nga sekretare gjyqësore Dolores Zemanaj, sot më datë 13.06.2023 përfundoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile, që i përket:

**KERKUES:** Dhionisios Alfred Beleri i biri Petro dhe Kasiani, datëlindja 09.08.1972, lindur dhe banues ne Himare, perfaqesuar ne gjykim nga av.Irakli Koco nepermjet prokures se posacme te dates 08.06.2023.

**OBJEKTI:** Vërtetimi i mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himare z.Dhionisios Alfred Petro Beleri propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashke Fitojme” per zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 14.05.2023

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr.139/2015 “Për Qeverisjen Vendore”, neni 60 pika 1 e në vazhdim.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Gjykata, pasi dëgjoi perfaqesuesin e kerkuesit z.Dhionisios Alfred Beleri, av.Irakli Koco i cili kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit, si dhe pasi shqyrtoi në tërësi materialet e fashikullit të gjykimit dhe legjislacionin në fuqi,

## V Ë R E N

Përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kerkuesi Dhionisios Alfred Beleri ka paraqitur kërkesën për verifikimin e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himare. Rezulton se kerkuesi ka kandiduar për Kryetar Bashkie për Bashkinë Himare, si kandidat i propozuar nga subjekti zgjedhor “Bashke Fitojme” në zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore të zhvilluara në datë 14.05.2023.

Nga akti me nr.194 date 16.05.2023 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Himare”, i KQZ (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve), të plotësuar nga Grupet e Numërimit me Tabelen Përmbledhëse të Rezultatit është vendosur:

“1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Himare z.Dhionisios Alfred Beleri, të propozuar nga “Bashke Fitojme”.

Nga shkresa me lende “Vërtetim”, nr.5750 Prot. datë 01.06.2023 e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve rezultoi se ndaj vendimit nr.611 date 25.05.2023, nuk është depozituar

asnjë kërkesë ankimore. Në të tilla kushte kërkuesi Dhionisios Alfred Beleri i është drejtuar Gjykatës për vërtetimin e mandatit të tij për Kryetar të Bashkisë Himare.

Me shortin elektronik datë 01.06.2023 kjo çështje i'u caktua për gjykim këtij trupi gjykues. Gjykata duke patur parasysh datën e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për dhenien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Himare Qarku Vlore z.Dhionisios Alfred Petro Beleri propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni "Bashke Fitojme" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 dhe shpalljen fitues të z.Dhionisios Alfred Beleri dhe afatin 20 ditor të përcaktuar nga neni 60/1 i Ligjit Nr. 139/2015 "Për qeverisjen vendore", caktoi seancën për në datën 22.07.2019, ora 11:00 duke urdhëruar njoftimin e kërkuetit.

Referuar nenit 60 të Ligjit të sipërcituar, i cili parashikon:

"1. Mandati i kryetarit të bashkisë vërtetohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, (dhoma civile) në juridiksionin e së cilës përfshihet bashkia përkatëse, brenda 20 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit të zgjedhjes së tij.", Gjykata çmoi se është kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Vleresimi i Gjykatës

Gjykata vëren se, rezultoi se kërkuesi z.Dhionisios Alfred Petro Beleri ka kandiduar për Kryetar Bashkie për Bashkinë Himare si kandidat i propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni "Bashke Fitojme" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023.

Nepermjet shkresës me nr.195 datë 16.05.2023 "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Himare", i KQZ (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve), të plotësuar nga Grupet e Numërimit me Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit është vendosur:

"1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Himare z.Dhionisios Alfred Beleri, të propozuar nga "Bashke Fitojme".

Nga shkresa me lende "Vërtetim", nr.5750 Prot. datë 01.06.2023 e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve rezultoi se ndaj vendimit nr.611 datë 25.05.2023, nuk është depozituar asnjë kërkesë ankimore.

Konform nenit 60/2 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për qeverisjen vendore", i cili parashikon:

"2. Deklarimi i pavlefshmërisë së mandatit të kryetarit bëhet kur vërehet se nuk plotësohen kushtet, sipas nenit 45 të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.", Gjykata mori në analizë si vijon:

Neni 45 i Kushtetutës parashikon se:

"1. Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.

2. Përfshihen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paqftë mendërisht.

3. Përfshihen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në rastet përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t'u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike.

4. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.", ndërsa në Nenin 109 të saj,

parashikohet se:

“1. Organet përfaqësuese të njësisive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilat zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.

2. Organi ekzekutiv i bashkisë ose i komunës është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Të drejtën e zgjedhjes në këshillat vendorë dhe si kryetar bashkie ose komune e kanë vetëm shtetasit që janë me banim të përhershëm në territorin e njësisë vendore përkatëse...”.

Referuar nenit 122 të K.Zgjedhor, sipas të cilit:

“1. Tabela përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor nxirret nga KZAZ-ja jo më vonë se ora 22:00 e ditës së nesërme të votimit.

2. Menjëherë pas përfundimit të numërimit, sipas procedurave të përcaktuara në nenet 116 deri në 119 të këtij Kodi, KZAZ-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve për zonën që administron, në të cilën pasqyrohen rezultatet e çdo subjekti për çdo qendër votimi, sipas origjinaleve të tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi të plotësuar nga grupet e numërimit.

3. Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së miratohet me vendim të KZAZ-së. Në rast të kundërt veprohet në përputhje me nenin 35 pika 5 të këtij Kodi. Një kopje e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve dhe tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi, dërgohet menjëherë në KQZ, përfshirë edhe rrugët elektronike të komunikimit.

4. Kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së, tabelave të rezultateve të qendrave të votimit dhe kopje të Procesverbalit të Konstatimit u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, ndërsa origjinalet e tyre, vulat dhe çdo material tjetër zgjedhor dorëzohen në KQZ.

5. Në rast të zgjedhjeve vendore, KZAZ-ja miraton me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të bashkisë. Në rastet kur territori i bashkisë nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme, çdo KZAZ miraton me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për atë pjesë të territorit të bashkisë.

Në çdo rast KZAZ-ja zbaton të njëjtat kritere dhe procedura të përshkruara në këtë nen. Vendimi ankimohet sipas procedurave të përcaktuara në Pjesën X të këtij Kodi. 6. Kopja origjinale e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të KZAZ-së dhe Tabelat e Rezultateve për çdo qendër votimi i dërgohen KQZ-së për të nxjerrë rezultatin, sipas nenit 123 të këtij Kodi”, dhe nenit 123 të tij, sipas të cilit: “1. KQZ-ja verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për zonën zgjedhore për Kuvendin apo për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse. Për këtë, KQZ-ja plotëson Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore dhe e miraton atë me vendim jo më vonë se 48 orë nga mbërritja e të gjitha tabelave të zonës zgjedhore”, Gjykata konstaton se u paraqit vendimi nr. 996, datë 08.07.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Himare, rezultoi se është vendosur:

“1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Himarë.”

Bashkangjitur këtij vendimi është depozituar prej kërkuesit edhe Tabela Përmbledhëse e Rezultateve Për Kandidatin për Kryetar të Bashkisë Himare.

Nga shkresa me lende “Vërtetim”, nr.5750 Prot. datë 01.06.2023 e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve rezultoi se ndaj vendimit nr.611 date 25.05.2023, nuk është depozituar asnjë kërkesë ankimore. Në të tilla kushte kërkuesi Dhionisios Alfred Beleri i është drejtuar Gjykatës për vërtetimin e mandatis të tij për Kryetar të Bashkisë Himare. Në të tilla kushte Gjykata çmon se kërkesa e paraqitur prej kërkuesit z.Dhionisios Alfred Beleri duhet pranuar.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 126, 306 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 60 të Ligjit N 139/2015 “Për qeverisjen vendore”;

## VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës.
2. Vërtetimin e Mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himare z.Dhionisios Alfredo Petro Beleri propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashke Fitojme per zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 14.05.2023
3. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

U shpall sot ne Vlore me date 13.06.2023

**SEKRETARE  
DOLORES ZEMANAJ**



**GJYQTARE  
HERILA CELA**

